REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

RAPORT VJETOR

I VEPRIMTARISË

2025

Tabela e Përmbajtjes

HYRJA **4**

OBJEKTIVAT. **6**

VEPRIMTARITË NË PËRPUTHJE ME KUADRIN E RI LIGJOR. **7**

ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I TRAJNIMEVE. **8**

PROGRAMET E TRAJNIMIT PËR VITIN 2025 ..... *9*

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE. **10**

1. VEPRIMTARI TRAJNUESE *10*

2. VEPRIMTARI LIGJORE *11*

3. VLERËSIMI I CILËSISË SË TRAJNIMEVE NGA PJESËMARRËSIT *11*

4. VLERËSIMI I CILËSISË SË TRAJNIMEVE *12*

5. STUDIME NË FUSHËN FISKALE *13*

VEPRIMTARITË NË FUSHËN E EDUKIMIT FISKAL. **14**

1. TRAJNIMET *14*

2. PROGRAMET E TRAJNIMIT *14*

3. PJESËMARRËSIT NË TRAJNIME *14*

4. NUMRI I ORËVE TË TRAJNIMIT *15*

5. VLERËSIMI I NJOHURIVE TË PUNONJËSVE NIVELI BAZË: *15*

6. TRAJNIMI I TRAJNERËVE DHE BASHKËPUNIMI MË KOSOVËN *15*

7. TRAJNIMI I PUNONJËSVE TË BASHKISË TIRANË *16*

8. METODAT TRAJNUESE *16*

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE **18**

Trajnime të punonjësve niveli bazë *18*

Foto nga trajnimet me punonjësit e rinj të administratës tatimore 26

Testimi për punonjësit e nivelit bazë administrata tatimore 27

Trajnime të punonjësve niveli funksional *28*

Foto nga trajnimet me punonjësit e nivelit funksional të administratës tatimore 37

Trajnime të punonjësve niveli vazhdues *38*

Foto nga trajnimet me punonjësit e nivelit vazhdues të administratës tatimore 41

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE **42**

Trajnime të punonjësve niveli funksional *42*
Foto trajnime niveli funksional 51
Trajnime të punonjësve niveli vazhdues *52*
Foto trajnime niveli vazhdues 56
Trajnime të punonjësve niveli bazë *57*
Testimi për punonjësit e nivelit bazë administrata doganore 67
Aneks I: Tabela e të dhënave për trajnimet me administratën tatimore. 68
Aneks II: Tabela e të dhënave për trajnimet me administratën doganore. 73
Aneks III:Tabela përmbledhëse për trajnimet me administratën tatimore dhe doganore . 78
Aneks IV: Statistikat e cilësisë së trajnimeve nisur nga formularet e vlerësimit të trajnimit dhe trajnerëve nga ana e pjesëmarrësve 79
Aneks V: Realizimet nga Drejtoria e Trajnimit 80
Aneks VI: Realizimet Sektori i Shërbimeve Mbështetëse 83
Aneks VII: Analiza për realizimet nga Financa 85

HYRJA

Raporti vjetor 2025 i QTATD-së paraqet një përmbledhje të veprimtarive të realizuara në funksion të objektivave strategjike dhe planit operacional të institucionit, me fokus të veçantë në rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të administratës tatimore dhe doganore.

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore (QTATD) ka vijuar me përpjekjet e saj për të konsoliduar rolin si një strukturë qendrore trajnimi, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 14.09.2022, si edhe aktet nënligjore në zbatim.

Në fillim të vitit 2025 si strukturë e re e QTATD filloi funksionimin Drejtoria e Trajnimeve, e përbërë nga trajnerë të brendshëm, të cilët përveç mësimdhënies, kanë vlerësuar gjatë gjithë kësaj periudhe trajnimet dhe mënyrën e shpjegimit të leksioneve nga trajnerët e jashtëm. Secili trajnim është orientuar drejt modelit bashkëkohor të mësimdhënies për të rriturit. Zbatimi i rregullores së brendshme dhe i rregullores së trajnimit, të hartuara nga Qendra dhe të miratuara nga Ministri i Financave në Janar 2025, ka mundësuar një funksionim më të strukturuar dhe të qëndrueshëm të veprimtarive të Qendrës.

Janë hartuar dhe zhvilluar programe trajnimi të orientuara nga nevojat konkrete të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD). Në bazë të tre nivele, Qendra ka synuar shtimin e njohurive të përgjithshme për punonjësit e rinj të administratave fiskale, thellimin e njohurive të legjislacioneve përkatëse mbi poziconet specifike të punës dhe zgjerimin e njohurive mbi ndryshimet e reja ligjore në fushat fiskale.

Trajnimet u konceptuan dhe u realizuan në mënyrë të strukturuar, duke u fokusuar në prakticitetin dhe bashkëpunimin mes pjesëmarrësve, për të nxitur shëmbimin e përvojave dhe konsolidimin e njohurive të praktikave të punës.

Në përputhje me objektivat strategjikë, të përmëndura më poshtë në këtë raport, si edhe planin operacional të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore (QTATD), gjatë vitit 2025, një fokus i veçantë i veprimtarisë ka qenë në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies për të rriturit. Në funksion të misionit të institucionit për të krijuar dhe zgjeruar njohuritë praktike dhe teorike të administratës fiskale tatimore dhe doganore, janë zbatuar metoda që vendosin në qendër të procesit të të nxënit

pjesëmarrësin dhe përvojën e tij, duke u fokusuar në rastet konkrete të hasura nga punonjësit gjatë punës së tyre të përditshme.

Metodat e përdorura përfshijnë qasjen interaktive, të bazuar në analizën e rasteve konkrete nga praktika tatimore dhe doganore, zgjidhjen e problemeve në grup, diskutime të strukturuara, simulime dhe role-playing, të cilat nxisin të menduarit kritik, bashkëpunimin dhe zbatimin e njohurive në situata reale pune.

Në përputhje me planet e Qendrës, trajnerët e përzgjedhur janë udhëzuar dhe orientuar drejt rolit të lehtësuesit të të nxënit, duke promovuar një qasje mësimore interactive dhe bashkëpunuese. Në këtë kontekts, sesionet janë të dizenjuara për të qënë dinamike, të strukturuara dhe të fokusuar në adresimin e nevoja specifike të pjesëmarrësve, duke nxitur gjatë leskionit diskutimin reflektiv, analizën kritike dhe shkëmbimin e përvojave praktike. Kjo metodologji synon jo vetëm zhvillimin professional të qëndrueshëm të individëve, por edhe konsolidimin e kapaciteteve institucionale, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet niveleve të ndryshme të strukturave dhe promovimin e një kulture të mësimit të vazhdueshëm në nivel organizati.

Këto metoda janë projektuar jo vetëm për të përmbushur nevojat e tanishme të DPT dhe DPD, por edhe për t'u përshtatur me ndryshimet e shpejta në legjislacion dhe praktikat fiskale, si dhe për të krijuar një kulturë institucionale të të nxënit të vazhdueshëm dhe shkëmbimit të njohurive ndërmjet punonjësve të niveleve dhe profileve të ndryshme brenda administratës tatimore dhe doganore.

Në përputhje me objektivat strategjikë të qeverisë në procesin e integrimit evropian, veprimtaria e Qendrës eshte orientuar në forcimin e kapaciteteve institucionale.

Procesi i trajnimit ndikon në rritjen e aftësive teknike dhe menaxheriale të punonjësve, si edhe në rritjen e etikës, profesionalizmit dhe besueshmërisë në publik të punonjësve të organeve fiskale. Trajnimi i punonjësve të administratës tatimore dhe doganore shërben në përthithjen e dijeve të duhura, të cilat do t'i duhen stafit fiskal gjatë rrugës për përmbushjen e kritereve që Shqipëria duhet të realizojë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Qendra ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të realizimit të studimeve në fushën e edukimit dhe sistemit fiskal, si pjesë e angazhimit të saj për të nxitur qasjen kërkimore dhe rritjen profesionale të vazhdueshme.

OBJEKTIVAT.

Qendra ka pasur në veprimtarinë e saj të 2025 këto objektiva kryesore:

Implementimi i reformës së Qendrës së Trajnimit të Adminstratës Tatimore dhe Doganore, nëpërmjet zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602 datë 14.09.2022, "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore (QTATD)" dhe akteve nënligjore të hartuara në zbatim.

Strukturë e re organike e plotë që përfshin marrjen e trajnerëve të brendshëm, për të cilën është krijuar një drejtori e re. Struktura nuk është plotësuar akoma, ka vende të lira që janë në proces rekrutimi. Trajnerët aktualë kanë filluar me vlersimin e cilësisë për secilin trajnim të zhvilluar, duke nxjerrë edhe rekomandime mbi përmirësimin e procesit.

Zbatimi i rregulloreve të Brendshme dhe asaj të Trajnimit për Qendrën të miratuara nga Ministri i Financave në janar 2025.

Hartimi i programeve të duhura të trajnimit për administratën fiskale tatimore e doganore sipas nevojave të DPT dhe DPD. Programet janë hartuara në tre nivele: të rinj, funksionalë dhe vazhdues, për të përfshirë të gjitha kategoritë e punonëjsve të administratave fiskale.

Organizimi i trajnimeve në mënyre efektive dhe efiçente. Trajnimet janë zhvilluar në sallë, si edhe në raste të ndryshme janë zhvilluar në degë rajonale për të pasur një përfitim më të madh nga pjesëmarrësit.

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i workshopeve drejt çështjeve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit. Secili trajnim përmban raste praktike nga administratat respektive, si edhe raste të ngritura gjatë trajnimit nga pjesëmarrësit, mbi problematikat e hasura në përditshmërinë.

Krijimi i njohurive të reja dhe zgjerimi i njohurive ekzistuese rreth sistemit fiskal dhe ligjor nëpërmjet trajnimeve, duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të njohurive mes kategorive të ndryshme të punonjësve të Administratës Tatimore dhe Doganore, aftësimin e tyre praktik dhe teorik.

Realizimi i studimeve në fushën e edukimit fiskal. Në vitin 2025 është hartuar studimi mbi krahasimi i legjislacionit shqiptar të akcizës me direktivat e BE, si edhe studimi mbi efektivitetin e TVSH- me fokus e-commerce.

VEPRIMTARITË NË PËRPUTHJE ME KUADRIN E RI LIGJOR.

VKM-ja Nr. 602 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore*", u zbatua në bazë të specifikimeve ligjore që përcaktohen aty lidhur me organizimin e trajnimeve dhe angazhimin e trajnerëve, si edhe në vitin 2025 u miratuan dhe dy dokumenta të rëndësishëm nënligjorë që i shërbejnë zbatimit të këtij kuadri ligjor.

Në zbatim të kësaj VKM-je kërkohej strukturë e re organizative që të përfshinte edhe trajnerë të brendshëm, e cila u miratua me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 46, datë 19.03.2024 për "Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore". U krijua një drejtori e re me 5 punonjës dhe në tre mujorin e parë të 2025 kjo drejtori filloi të plotësohej nga DAP me punonjës, një proces i ndërprerë për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme, dhe pritet të vijojë sërish me procesin e rekrutimit.

Në bazë të VKM-së dhe në mbështjetje të funksionimit të strukturës së re u hartuan dhe u miratuan rregulloret: e brendshme dhe e trajnimit.

U hartuan tre lloje të programeve të trajnimit të veçanta për dy administratat tatimore e doganore për:

- të rinjtë-niveli bazë,
- nivelin funksional,
- nivelin vazhdues.

Për punonjësit e rinj, u aplikuan programet afat-mesëm, që i dhanë mundësi të rinjve të krijonin dhe konsolidonin njohuri në çdo fushë.

Për nivelin funksional, pjesëmarrësit thelluan njohuritë e tyre teorike dhe praktike për një fushë të caktuar, të lidhur me detyrat e tyre funksionale.

Për punonjësit vazhdues, ku njohuritë përforcohen ose aty ku ka ndryshime krijohen të reja.

ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I TRAJNIMEVE.

Qendra, pas diskutimit me organet fiskale, këshillimit në Këshillin Konsultativ, miratoi programet e trajnimit për vitin 2025. Për qëllime të organizimit të veprimtarive hartoi **kalendarët** e trajnimeve si mjet për zhvillimin në kohën e duhur të trajnimit të kërkuar profesional të punonjësve të administratës tatimore dhe doganore.

Qendra **planifikoi** veprimtaritë e saj bazuar në filozofinë e zhvillimit ose përmirësimit profesional gjatë të punuarit të cilësive teknike, që kanë të bëjnë me efektivitetin në punë, si edhe të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me detyrat e përditshme të vendit të punës. Inspektorëve të tatimeve dhe punonjësve të doganave ju dha mundësia e **zhvillimit profesional pa pagesë** gjatë trajnimeve të përgatitura nga një nivel i lartë profesional trajnerësh dhe që varion gjerësisht në lidhje me filozofinë, përmbajtjen dhe formatin e eksperiencave të të mësuarit.

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i trajnimeve u fokusua drejt seminarëve praktikë, duke zbatuar parimet e mësimdhënies për të rriturit.

Trajnimet u zhvilluan në sallë, duke krijuar mundësinë e ndërveprimit aktiv mes pjesëmarrësve dhe trajnerëve.

Trajnimet u zhvilluan gjithashtu në degë të ndryshme tatimore dhe doganore, duke mundësuar jo vetëm organizimin e trajnimit, por dërgimin e trajnimit tek pjesëmarrësi.

Trajnerët duke qenë se mbulojnë në jetët e tyre profesionale, si pjesë e organeve fiskale, çështjet teknike u orientuan drejt shpjegimit të rasteve konkrete nga praktika e punës, duke ia bërë më të prekshme temën e trajnimit pjesëmarrësve dhe duke pasur mundësinë që të ofrojnë zgjidhje ose unifikim interpretimesh.

PROGRAMET E TRAJNIMIT PËR VITIN 2025.

U zhvilluan për 2025 programet e trajnimit si më poshtë:

ADMINISTRATA TATIMORE:

- Programi i Trajnimit për **punonjësit e rinj, 13 Tema, 18 ditë, 108 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin funksional, 18 Tema, 21 ditë, 126 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin vazhdues, 7 Tema, 12 ditë, 72 orë trajnimi për çdo rajon.**

ADMINISTRATA DOGANORE:

- Programi i Trajnimit për **punonjësit e rinj, 15 Tema, 16 ditë, 96 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin funksional, 18 Tema, 18 ditë, 108 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin vazhdues, 7 Tema, 7 ditë, 42 orë trajnimi, për çdo rajon.**

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE.

Në zbatim të VKM, nr.602, datë 14.09.2022 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore*", u hartuan programet dhe u planifikua organizimi i trajnimeve për 3 kategori programesh si me poshtë:

1. VEPRIMTARI TRAJNUESE

		TRAJNIME
•	Bazë	Organizuar për punonjësit dhe nëpunësit e rinj të administratës tatimore dhe doganore me qëllim që të pajisen me njohuri të rëndësishme themelore përkatëse të çdo fushe. Sipas këtijprogrami u trajnuan: • *Administrata tatimore***: 79 punonjës në 13 tema- 216 orë trajnimi.** • *Administrata doganore***: 6 punonjës në 15 tema- 96 orë trajnimi.** • *Të trajnuar total*: **85 punonjës në 28 tema- 312 orë trajnimi.**
•	Funksional	Organzuar për punonjësit dhe nëpunësit e administrates tatimore dhe doganore, për specializim në vendin e punës ose për zhvillimin e karrierës, ku njohuritë themelore dhe të përgjithshme thellohen përmes trajnimit që lidhet me funksionet përkatëse administrative. Sipas këtij programi u trajnuan: • *Administrata doganore***: 248 punonjës në 18 tema- 102 orë trajnimi.** • *Administrata tatimore***: 459 punonjës në 18 tema- 126 orë trajnimi.** • *Të trajnuar total*: **707 punonjës në 35 tema- 228 orë trajnimi.**
•	Vazhdues	Organizuar për të gjithë punonjësit dhe nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore, me qëllimin që të krijohen njohuri të reja për çështje të veçanta dhe përditësimin e atyre ekzistuese, sipas dinamikave të fushës dhe të shkëmbehen përvojat dhe të transferohen njohuritë dhe dialogu ndërmjet stafit, lidhur me përditësimin me legjislacionin dhe praktikat e reja të zbatueshme. Sipas këtij programi u trajnuan: • *Administrata doganore***: 257 punonjës në 7 tema- 210 orë trajnimi.** • *Administrata tatimore***: 250 punonjës në 7 tema- 72 orë trajnimi.** • *Të trajnuar total*: **punonjës në 14 tema- 282 orë trajnimi.**

2. VEPRIMTARI LIGJORE

VEPRIMTARITË SIPAS KUADRIT TË RI LIGJOR
• Filloi funksionimi i strukturës së re organizative, u punësuan një pjesë e trajnerëve nga DAP. U miratuan manualet e punës për funksionet e kësaj drejtorie dhe asaj të programeve, si edhe manuali i vlerësimit të cilësisë ku dokumentohen proceset e punës me Urdhrin nr.16, datë 04.03.2025.
• U draftuan programet e reja të trajnimit mbi bazën e specifikimeve ligjore.
• U miratua rregullore e brendshme dhe ajo e trajnimit.

3. VLERËSIMI I CILËSISË SË TRAJNIMEVE NGA PJESËMARRËSIT

• **Numri total** i pjesëmarrësve që morën pjesë në vlerësim: **357.**
• Trajnimet u vlerësuan nga : ➢ **355** ose 99.5% e pjesëmarrësve: **shumë mirë** ➢ **2** ose 0.5% e pjesëmarrësve: **mirë** ➢ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: mjaftueshëm ➢ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët
• Trajnerët u vlerësuan nga : ➢ **355** ose 99.5% e pjesëmarrësve: **shumë mirë** ➢ **2** ose 0.5% e pjesëmarrësve: **mirë** ➢ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: mjaftueshëm ➢ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët

Sipas procesit të ri të vlerësimit: **Total** u plotësuan **1146 formularë** vlerësimi:

	Shumë dakord	**Dakord**	**Neutral**	**Jo dakord**	**Aspak dakord**
Nga trajnimi mora njohuri që mund të më ndihmojnë profesionalisht	1037	102	7		
Materiali i trajnerit ishte i kuptueshëm dhe përfshinte pikat kryesore rreth temës	1034	101	10		1
Trajneri ishte i përgatitur dhe me njohuri rreth temës	1076	63	7		
Shpjegimi nga ana e trajnerit ishte i qartë dhe i kuptueshëm	1068	67	11		
Gjatë trajnimit u trajtuan raste praktike	994	136	16		
Trajneri i përfshiu pjesëmarrësit në diskutime dhe pyetje	1025	112	8		1
Trajnimi kishte lidhje me punën time të përditshme	941	159	45	1	

4. VLERËSIMI I CILËSISË SË TRAJNIMEVE

Mbështetur në Rregulloren e Trajnimeve në QTATD-së, Nr.2 datë 07.01.2025 të Ministrit të Financave, Qendra vlereson cilesine para , gjate dhe pas trajnimit. Per vlerësimin e cilësisë së trajnimit u përdor metoda e shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga menaxheri i trajnimit para trajnimit, gjatë zhvillimit te trajnimit, formulari i vëzhgimit, pas trajnimit dhe në përfundim të tij raporti i menaxherit të trajnimit dhe raport vlerësimi nga trajneri.

Për vitin 2025 janë zhvilluar 78 tema trajnimi për DPT (38) dhe DPD (40) dhe janë vëzhguar direkt nga trajnerët e brendshëm 48 tema trajnimi të administratës tatimore (38) dhe doganore (10) për të cilat janë plotësuar 48 formular vëzhgimi për secilin trajner. Vlerësimi pasqyrohet në tabelën Aneksi V.

Në përfundim të programit të trajnimit të punonjësve të rinj (niveli bazë), në 13 tema për administratën tatimore dhe 15 tema për administratën doganore u zhvillua testimi për njohuritë e marra. Pas zhvillimit të testimit nga ana e Drejtorisë së Trajnimeve në zbatim të Nenit 24, pika 5 e "Rregullores së Trajnimit të QTATD-së" u krye në vijim kontrolli i testeve për 77 (shtatëdhjeteshtatë) pjesëmarrës në trajnim nga administrata tatimore dhe 6 (gjashtë) pjesëmarrës

në trajnim nga administrata doganore duke mbyllur në vijim të gjitha procedurat e kërkuara sipas Rregullores së Trajnimeve të QTATD-së, Nr. 2, datë 07.01.2025.

Eshtë shqyrtuar dokumentacioni i plotë për të gjitha temat e trajnimit të zhvilluara për vitin 2025, duke përfshirë raportet të menaxherit të trajnimit dhe raporte të vlerësimit nga trajneri i temës, mbi të cilat janë hartuar për të gjithë temat e Planit të Përgjithshëm Vjetor të Trajnimit raportet e vlerësimit të cilësisë së trajnimeve ku janë reflektuar treguesit, gjetjet kryesore dhe sugjerimet përkatëse.

Nga analiza e cilësisë rezultoi që në fazën para trajnimit: programet janë hartuar sipas nevojave të administratave, propozuar prej tyre, analizuar nga Qendra, diskutuar në Këshill dhe më pas miratuar nga Qendra programi vjetor për vitin 2025.

Kurrikulat e trajnimit janë në përputhje me strukturën e miratuar nga Qendra.

Trajnerët dhe materialet e trajnimit ishin në përputhje me temën e miratuar të trajnimit.

Gjatë trajnimit u vëzhguan të gjithë komponentët e tij dhe u vu re që trajneret vepruan në përputhje me metodat e të mësuarit për të rritur, kishte dikutime, leksionet ishin interaktive dhe me raste praktike.

Pas trajnimit u bënë testimet e duhura të njohurive nga rezultati i të cilave kuptohet që niveli absorbimit të dijeve është i duhuri.

Nga analiza e kontrollit të cilësisë nëpermjet raportimeve të trajnerëve rezultoi që interesi ishte i lartë, pjesëmarrja si edhe niveli i të kuptuarit dhe zgjidhjes së rasteve praktike ishte ai i pritshmi.

Po kështu nga analiza e vlerësimit të cilësisë të bërë nga pjesëmarrësit doli konkluzioni që trajnerët ishin të përgatitur dhe të gatshëm të zgjidhnin çështjet e ngritura, si nga pikëpamja teorike, ashtu edhe praktike.

5. STUDIME NË FUSHËN FISKALE

QTATD-ja në vitin 2025 u përfshi në hartimin dhe publikimin e 2 (dy) studimeve në fushën e tatimeve dhe doganave, konkretisht:

1. Në lidhje me legjislacionin për akcizën në vendin tonë krahasuar me direktivën e BE për akcizën, ngjashmëritë dhe ndryshimet. Ligji shqiptar nr. 61/2012 "Për akcizën në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, (ligji nr. 61/2012) ka përafruar Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008 “Lidhur me masat e përgjithshme mbi akcizën, e cila shfuqizon direktivën 92/12/KE”, që është shfuqizuar përmes Direktivës (BE) 2020/262 (Direktiva 2020/262), e njohur si "Direktiva e re e Akcizës". Qendra zhvilloi një analizë krahasuese strukturore dhe të përmbajtjes, ku fokusi kryesor ishte në pikat që direktiva e BE-së sjell ndryshime thelbësore krahasuar me ligjin shqiptar aktual.

2. Gjithashtu Qendra zhvilloi një studim me temë “Efektiviteti i zbatimit të TVSH dhe tregtia elektronike (e-comerce)”. Ky studim synoi të krijonte një panoramë të legjislacionit sesi zbatohet

TVSH në Shqipëri dhe në vendet e BE. Gjithashtu në studim u tregua mbi rregullat e-commerce dhe mënyrën e zbatimit të saj.

VEPRIMTARITË NË FUSHËN E EDUKIMIT FISKAL.

1. TRAJNIMET

Programet e Trajnimit përfshinin çështje bazë dhe specifike që lidhen me të kuptuarit e kuadrit ligjor, administrimit si edhe të ndryshimeve ligjore të fushës fiskale. Pjesë të programit ishin tema trajnimi që përfshijnë dhe thellimin e njohurive të pjesëmarrësve në kuadër të trajnimeve me nivelin funksional.

Përzgjedhja e temave të trajnimit u mbështet kryesisht në kërkesat e administratave fiskale, në bazë të identifikimit që ato i bëjnë nevojave për trajnim në tema dhe njerëz, si edhe në sugjerimet e pjesëmarrësve dhe të trajnerëve dhe u paraqitën për diskutim dhe për miratim në Këshillin Konsultativ të Qendrës.

2. PROGRAMET E TRAJNIMIT

• Administrata **tatimore: miratuar 38 tema trajnimi për 3 kategori pjesëmarrësish** (të rinj, vazhdues dhe funksional).
• Administrata **doganore: miratuar 40 tema trajnimi për 3 kategori pjesëmarrësish** (të rinj, vazhdues dhe funksional).
• Të dy administratat tatimore dhe doganore: miratuar **78 tema në total.**

3. PJESËMARRËSIT NË TRAJNIME

• **Pjesëmarrës** në trajnime nga **administrata tatimore** për vitin 2025- **788 punonjës.**
• **Pjesëmarrës** në trajnime nga **administrata doganore** për vitin 2025- **511 punonjës.**
• **Total pjesëmarrës: 1299**

4. NUMRI I ORËVE TË TRAJNIMIT

• **Orë** të trajnimit për administratën tatimore për 2025: **414 orë.**
• **Orë** të trajnimit për administratën doganore për 2025: **408 orë.**
• **822 orë total** për të dy administratat.

5. VLERËSIMI I NJOHURIVE TË PUNONJËSVE NIVELI BAZË:

ADMINISTRATA TATIMORE

• **Numri total** i pjesëmarrësve që morën pjesë në testim: **77**
• Pjesëmarrësit u vlerësuan: ➢ **10** ose 13% e pjesëmarrësve: **shkëlqyer (81-100 pikë)** ➢ **45** ose 58% e pjesëmarrësve: **shumë mirë (61-80 pikë)** ➢ **22** ose 29% e pjesëmarrësve: **mirë (51-60 pikë)** ➢ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët (0-50 pikë)

ADMINISTRATA DOGANORE

• **Numri total** i pjesëmarrësve që morën pjesë në testim: **6**
• Pjesëmarrësit u vlerësuan: ➢ **1** ose 17% e pjesëmarrësve: **shkëlqyer (81-100 pikë)** ➢ **3** ose 50% e pjesëmarrësve: **shumë mirë (61-80 pikë)** ➢ **2** ose 33% e pjesëmarrësve: **mirë (51-60 pikë)** ➢ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët (0-50 pikë)

6. TRAJNIMI I TRAJNERËVE DHE BASHKËPUNIMI MË KOSOVËN

QTATD në bashkëpunim më projektin e Ambasadës Angleze UC-SATA (Unlocking Change-Strengthening Albania's Tax Administration) zhvilloi trajnimin e trajnerëve, me trajnerët e jashtëm që janë aktivë në mësimdhënie pranë Qendrës. Trajnimi u fokusua në metodat e mësimdhënies për të rritur. Në këtë trajnim morën pjesë dhe punonjës të administratës tatimore të Kosovës, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në zbatim të marrveshjes për krijimin e qendrës së përbashkët trajnuese mes dy palëve.

7. TRAJNIMI I PUNONJËSVE TË BASHKISË TIRANË

Qendra pas kërkesës së Bashkisë Tiranë, zhvilloi trajnimin mbi procedurat tatimore, vlersimin dhe mbledhjen e borxhit me punonjësit e taksave vendore të Bashkisë Tiranë. Trajnimi pati një ndërthurje dhe krahasim mes procedurave që ndërmerr adminsitrata tatimore dhe rasteve që trajtohen nga punonjësit e taksave lokale.

8. METODAT TRAJNUESE

Diskutimi i rasteve praktike: vendosen pjesëmarrësit në rolin e vendimmarrësit përballë një problematikë reale. Çdo seminar fokusohet në analizën e situatave konkrete dhe diskutimin e alternativave të zgjidhjes, duke nxitur të kuptuarit e thellë, reflektimin dhe përfshirjen aktive të punonjësve në procesin e të nxënit.

Përdorimi i trajnerëve nga radhët e vetë administratës fiskale: synon transferimin e njohurive praktike nga profesionistët me përvojë, përmes demonstrimeve dhe analizës së rasteve që ndërthurin teorinë me praktikën. Ajo forcon ndërveprimin mes kolegëve dhe promovon ndarjen e përvojës institucionale.

Diskutimi i çështjeve të hasura nga pjesëmarrësit: trajnimi shndërrohet në një hapësirë për mësim kolektiv, ku punonjësit ndajnë problematika të përditshme dhe mësojnë nga njëri-tjetri, duke forcuar një qasje bashkëpunuese dhe zgjidhëse ndaj sfidave profesionale.

Leksionet studimore: përdoren për të ndihmuar në interpretimin korrekt të neneve ligjore dhe për të adresuar dilema të lidhura me zbatimin e legjislacionit fiskal. Kjo metodë mbështet rritjen e saktësisë dhe koherencës në zbatimin e ligjeve nga ana e administratës.

Konsultimet individuale dhe në grup: synojnë të rrisin ndërgjegjësimin profesional të pjesëmarrësve, duke ofruar mundësi për reflektim mbi praktikat e tyre, këshillim teknik dhe zhvillim të vazhduar profesional.

Mbikëqyrja reflektive: Një element i rëndësishëm i cilësisë së trajnimit, ku përmes pyetësorëve dhe mekanizmave të vlerësimit, vëzhgohet dhe analizohet përparimi i pjesëmarrësve dhe cilësia e procesit mësimor, me qëllim përmirësim të vazhdueshëm në të ardhmen.

Asistenca teknike: Ofrimi i materialeve mbështetëse, përfshirë legjislacionin primar e sekondar, udhëzues dhe manuale praktike, i mundëson pjesëmarrësve të përditësojnë njohuritë dhe të aplikojnë informacionin në mënyrë të saktë në vendin e punës.

Testimet dhe vlerësimet: Përdoren për të matur nivelin e njohurive pas trajnimit, për të identifikuar boshllëqet dhe për të përcaktuar nevojat për trajnim të mëtejshëm, në përputhje me zhvillimet ligjore të fushës fiskale.

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE

Trajnime të punonjësve niveli bazë

AKTIVITETI I

"Të ardhurat personale."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 72 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimi Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Kuptimi, fusha e veprimit, shtritja e detyrimit, burimi i të ardhurave.
- Tatimi mbi të ardhurat personale nga paga, transferimi i pasurisë së paluajtshme.
- Deklarata individuale vjetore e të ardhurave.
- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të rinj të administratës tatimore lidhur me ligjin e ri për tatimin mbi të ardhurat që ka hyrë në fuqi nga janari 2024. U trajtua ligji për pjesën e të ardhurave personale dhe u diskutuan raste për çdo pikë të ligjit për të bërë më praktike dhe mënyrën e zbatimit të ligjit nga inspektorët tatimorë.

AKTIVITETI II

"Njohuri bazë në legjislacionin tatimor"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 55 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse,

Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale .

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Llojet e tatimeve dhe taksave.
- Organizimi i administratës tatimore.
- Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin.
- Integriteti, korrupsioni dhe shkeljet e integritetit.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore me qëllim dhënien e njohurive bazë të legjislacionit tatimor, kontrollit Tatimor, shërbimit të tatimpaguesve, rregjistrimit të tatimpaguesve, ndryshimet në rregjistrim, menaxhimi i çështjeve në sistem dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ATSH.

AKTIVITETI III

"Tatimi mbi vlerën e shtuar"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 64 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Personi i tatueshëm, transaksionet e tatueshme.
- Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, vendi i furnizimit.
- Vlera e tatueshme, shkalla tatimore, lindja e tatimit.
- Përjashtimet, furnizimet me shkallë zero, eksportet.
- Zbritshmeria dhe kufizimet e zbritjes.
- Deklarimi, pagesa dhe faturat.
- Rimbursimi.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me bazën ligjore për TVSH, për të përmirësuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Pjesëmarrësit kanë

zgjeruar njohuritë e tyre lidhur me kuadrin ligjor, si dhe thelluar njohuritë mbi të ardhurat që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale, shkallën tatimore, deklarimin individual vjetor të të ardhurave etj.

AKTIVITETI IV

"Kontrolli tatimor"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 70 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Llojet e kontrollit tatimor dhe analiza e riskut.
- Rivlerësimi tatimor, mënyrat e kryerjes dhe dokumentimit.
- Vlerësimi me metoda alternative.
- Kundravajtjet administrative.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të rinj administratës tatimore mbi qëllimin e kontrollit tatimor, dokumentat dhe të dhënat mbi të cilat kryhet kontrolli, kur nxirret njoftimi i kontrollit si përzgjidhet tatimpaguesi për kontroll, analiza e rriskut, afatet e kryerjes së raport kontrollit paraprak dhe përfundimtar, njoftim vleresimi për detyrimi dhe e drejta e ankimimit, kur kryhen rikontrollet dhe kush ka të drejtë ti miratojë ato, kur meret specialist të jashtëm apo asistencë e huaj dhe rastet kur përjashtohet inspektori nga kontrolli.

AKTIVITETI V

“Mbledhja me forcë e detyrimeve”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 64 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Masat e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor.
- Afati, kushtet dhe detyrimet për të cilat lidhet marrëveshja me këste.
- Ekzekutimi i masave shtrenguese, fshirja e borxhit

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të rinj administratës tatimore mbi procesin e matjes së ndikimit të trajnimit në performancën e nëpunësve synon të evidentojë, masën e ndikimit të trajnimeve në kuadër të sistemit, të institucionit dhe performancës individuale.

AKTIVITETI VI

“Apelimi tatimor dhe gjykata administrative”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 63 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Procedurat dhe afatet e ankimit. Aktet objekt apelimi administrativ.
- Pjesëmarrja në shqyrtimin e ankimit, provat dhe mënyra e vendimmarrjes.
- Gjykimi i çështjeve administrative tatimore në gjykatë.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të rinj administratës tatimore me apelimin tatimor dhe gjykimin admistrativ, veprimtaria administrative e administratës tatimore, si mund të apelohet, komisioni i shqyrtimit të apelimeve tatimore dhe cilat janë kushtet që duhen plotësuar për të apeluar.

AKTIVITETI VII

"Kontabiliteti"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 65 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Instrumentat financiare, inventarët.
- Aktivet.
- Të ardhurat dhe lidhja e tyre me shpenzimet, shpenzimi i tatimit mbi fitimin.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të rinj administratës tatimore, njohja me parimet bazë të kontabilitetit, ndarja e kontabilitetit, raportet, koncepte e nocione të përgjithshme mbi të ardhurat, të ardhurat e udhëtimit në sektorin publik, përmbajtja, klasifikimi dhe struktura.

AKTIVITETI VIII

"Tatimi mbi fitimin"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 71 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e

Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Fusha e veprimit, norma tatimore, përjashtimet, rezidenca
- Deklarimi tatimor, kundërvajtjet
- Shpenzimet e njohura dhe të panjohura
- Borxhet e këqija, rezervat speciale
- Kufizimet për kapitalizimin, kreditimi i tatimit të huaj
- Amortizimi
- Diferenca mes të ardhurave për qëllime të tatimit mbi fitimin dhe qarkullimit për TVSH

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të rinj të administratës tatimore lidhur me pjesën e tatimit mbi fitimit (tatimi koorporativ) së bashku me ndryshimet që ka pasur me ligjin e ri për tatimin mbi të ardhurat. Në këtë kuadër u trajtuan të gjithë pjesët përbërëse të këtij ligji, bashkë me shëmbuj përkatës nga praktika, si edhe deklaratat.

AKTIVITETI IX

“Tatimi në burim”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 60 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Të ardhurat që janë subjekt i tatimit në burim brenda vendit.
- Krahasimi i ligjit shqiptar me marrëveshjet tatimore.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të rinj të administratës tatimore lidhur me tatimin në burim, deklaratat, si edhe procedurat që ndiqen në përcaktimin e këtij tatimi.

AKTIVITETI X

"Kontrolli dhe auditi i brendshëm financiar"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 56 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Njohja me elementët e ligjit Nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar
- Manuali i auditimit të brendshëm
- Udhëzues-mbikqyrja e përpuethshmërisë financiare

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të rinj të administratës tatimore lidhur me parimet e auditit, zbatimin e manualit dhe shembuj konkret.

AKTIVITETI XI

"Sistemi C@ts"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 67 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Njohja mbi funksionimin e sistemeve tatimore C@TS, CPCM
- Deklaratat e implementuara në sistemin C@TS

- Të tjera mbi sistemin

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit bazë të administratës tatimore lidhur me Sistemin C@ts.

AKTIVITETI XII

"Marrëveshjet tatimore"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 51 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Fusha e zbatimit, rezidenca, trajtimi i individëve.
- Selia e përhershme.
- Interesat, dividendet, honoraret dhe kreditimi i tatimit

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit bazë të administratës tatimore lidhur me marrëveshjet tatimore, mënyrën e zbatimit dhe pikat kryesore që përmbajnë të tilla marrëveshje.

AKTIVITETI XIII

"Dokumentimi tatimor dhe fiskalizimi"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 70 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës, Hetimit Tatimor, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Detyrimi për dokumentim.
- Fiskalizimi dhe platforma qëndrore e fiskalizimit.
- Lëshimi i faturave të fiskalizuara.

- Zbatimi i proçedurës së fiskalizimit.
- Përdorimi i sistemit.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit bazë të administratës tatimore lidhur me procesin dhe risitë e fiskalizimit, mënyrën e lehtësimit që ka krijuar dhe zbatimin konkret.

Foto nga trajnimet me punonjësit e rinj të administratës tatimore



Testimi për punonjësit e nivelit bazë administrata tatimore

Në përfundim të programit të trajnimit për punonjësit e rinj të administratës tatimore, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore organizoi testimin mbi vlerësimin e njohurive të fituara nga pjesëmarrësit, ku morën pjesë 77 pjesëmarrës.

EVIDENCA

VLERËSIMI	NR. PUNONJËSISH
DOBËT (1-50)	0
MIRË(51-60)	22
SHUMË MIRË (61-80)	45
SHKËLQYER (81-100)	10
TOTAL	**77 Punonjës**

Foto nga testimi.





AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE

Trajnime të punonjësve niveli funksional

AKTIVITETI I

“ Kontrolli tatimor- niveli i avancuar.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar morën pjesë 27 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Planifikimi i kontrollit tatimor.
- Teknikat e analizës së tatimpaguesit.
- Vlerësimi me metoda alternative.
- Identifikimi dhe kontrolli i shmangieve tatimore

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve funskional të administratës tatimore që ofrojnë shërbime për qytetarët dhe kanë kontakt me ta. Thellimi në konceptet e kontrollit tatimor, rregullat dhe afatet e njoftimit, rikontrolli-proçedurat.

AKTIVITETI II

“Kontrolli nga Zyra.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 26 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Analizimi dhe monitorimi i deklarimeve tatimore të tatimpaguesve.
- Detyrat e tjera në varësi të kërkesave të tatimpaguesve.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve funskional të administratës tatimore. Njohja me funksionet e sekotrit të kontrollit nga zyra dhe monitorimit, e drejta për të nxjerrë vlerësimin

tatimor dhe për të përdorur mënyra alternative. Përdorim i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor.

AKTIVITETI III

“Mbledhja e Borxhit.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 15 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Borxhi tatimor, njoftimi dhe vlerësimi i detyrimeve.
- Masat e e sigurimit, sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes së pasurisë.
- Parashkrimi dhe shpallja e pambledhshëm e borxhit.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve funksional të administratës tatimore. Njohja me detyrimin tatimor të papaguara. Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë neni 97, parashikimi i së drejtës për fillimin e proçedurave për zbatimin e masave shtrënguese neni 100.

AKTIVITETI IV

“Dokumentimi Tatimor dhe Fiskalizimi.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 24 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Detyrimi për dokumentim.
- Fiskalizimi dhe platforma qëndrore e fiskalizimit.
- Lëshimi i faturave të fiskalizuara.
- Zbatimi i procedurës së fiskalizimit.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve funksional të administratës tatimore. Njohja me proçesimin e të dhënave, implementimin e taksimit dhe komunikimit me tatimpaguesin kryhen automatikisht me mbikqyrjen e faktorit njerëzor, elementet e projektit të ri monitorimi i transaksioneve me para në dorë. Avantazhet e sistemit të ri krahasuar me sistemin ekzistues monitorues në kohë reale.

AKTIVITETI V

"Kontrolli tatimor për fiskalizimin e faturave me para në dorë."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 30 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Parimet, objektivat dhe sekreti në kontrollet tatimore për fiskalizimin e faturave me para në dorë
- Protokolli, analiza dhe përgatitja e kontrollit tatimor të fiskalizimit
- Kryerja e kontrollit tatimor

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me kontrollet që ushtrohen nga inspektorët në lidhje me fiskalizimin e faturave me para në dorë.

AKTIVITETI VI

"Shërbimi i Tatimpaguesve."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 30 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Shërbimet që ofrohen në sportele dhe pranë administratës tatimore.
- Shërbimet që ofrohen online.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksioanl të administratës tatimore lidhur me shërbimet që ofrohen nga adminsitrata tatimore në ndihmë të tatimpaguesve, qofshin këto në sportele fizike apo shërbime online.

AKTIVITETI VII

"Të ardhurat personale."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 34 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Kuptimi, fusha e veprimit, shtritja e detyrimit, burimi i të ardhurave
- Tatimi i të ardhurave personale nga paga, transferimi i pasurisë së paluajtshme
- DIVA
- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me lidhin për tatimin mbi të ardhurat, duke u fokusuar tek tatimet personale.

AKTIVITETI VIII

"Tatimi mbi fitimin."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 27 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Fusha e veprimit, norma tatimore, përjashtimet, rezidenca
- Deklarimi tatimor, kundërvajtjet
- Shpenzimet e njohura dhe të panjohura
- Borxhet e këqija, rezervat speciale
- Kufizimet për kapitalizimin, kreditimi i tatimit të huaj
- Amortizimi
- Diferenca mes të ardhurave për qëllime të tatimit mbi fitimin dhe qarkullimit për TVSH

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me pjesën e tatimit mbi fitimit (tatimi koorporativ) sëbashku me ndryshimet që ka pasur me ligjin e ri për tatimin mbi të ardhurat. Në këtë kuadër u trajtuan të gjithë pjesët përbërëse të këtij ligji, bashkë me shëmbuj përkatës nga praktika, si edhe deklaratat.

AKTIVITETI IX

"Tatimi në burim."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 30 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Të ardhurat që janë subjekt i tatimit në burim brenda vendit
- Krahasimi i legjislacionit shqiptar me marrëveshjet tatimore

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me tatimin ne burim, deklaratat, si edhe procudurat që ndiqen në përcaktimin e këtij tatimi.

AKTIVITETI X

"Legjislacionin tatimor dhe ligjet e veçanta në përbërje të tij."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 27 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Krijimi i skemave mashtruese me TVSH dhe fshehja e të ardhuarve,
- Analiza e pasqyrave financiare
- Transferimi i çmimit

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur ligjet mbi të cilat funksionon AT.

AKTIVITETI XI

“Kontrolli Tatimor në Sektorë të veçantë.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 24 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë dhe përgjegjës nga Drejtoria e Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Furnizimi i gazit natyror, energjisë elektrike dhe ujit nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes
- Trajtimi i paketave të hoteleve
- Metodika e kontrollit të ndërtimit në raste për ndërtime individuale, ndërtime kompleksesh, objekte, etj.
- Tregtia online- raste konkrete

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me kontrolle specifike mbi të cilat funksionon AT.

AKTIVITETI XII

“Veprat penale në lidhje me taskat dhe tatimet.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 41 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Evazioni fiskal dhe tatimor. Format klasike të shfaqjes së evazionit.
- Përgjegjësia penale e personave juridikë.
- Sistemi ligjor i taksave dhe tatimeve lidhur me respektimin e të drejtave themelore.
- Partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër evazionit.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me veprat që konsiderohen shkelje penale në fushën tatimore.

AKTIVITETI XIII

“Udhëzimi mbi përjashtimin e TVSH për projektet që zbatohen nga donatorët e huaj.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 16 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Udhëzimin e ri të vitit 2025
- Ndryshimet që sjell udhëzimi
- Raste praktike

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me donacionet/grantet që përjashtohen nga TVSH.

AKTIVITETI XIV

“Analiza e Riskut”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 15 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Vlerësimi i riskut
- Risku i ulët dhe i lartë
- Metodologjia për uljen e riskut
- Strategjitë
- Roli i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur procedurat e menaxhimit të riskut dhe funksionimi i DMR.

AKTIVITETI XV

“Transferimi i veprimtarisë ekonomike, bashkimet me përpithje dhe ndarjet, rastet e rregullimit të TVSH”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 25 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Kuptimi i tranferimit të veprimtarisë ekonomike
- Aspektet proceduriale
- E drejta e zbritjes dhe rregullimit të TVSH

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me parimet transferimit të veprimtarisë ekonomike, rastet e bashkimit, si kryhet ndarja dhe si rregullohet TVSH.

AKTIVITETI XVI

"Parandalimi i pastrimit të parave"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 29 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Fshehja e të ardhurave
- Krijimi i skemave mashtruese me TVSH
- Huadhëniet mes shoqërisë dhe ortakëve
- Tranferimi i kapitalit, tjetërsimi

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me çështje të parandalimit të pastrimit të parave.

AKTIVITETI XVII

"Analiza Financiare në Kontrollin Tatimor"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 16 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Analizimi dhe interpretimi i pasqyrave financiare.
- Llogaritja dhe interpretimi i raporteve.
  Kufizimet e teknikave të interpretimit.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me formën e analizës financiare që kryhet nga kontrolli tatimor.

AKTIVITETI XVIII

“Njohuri mbi procedurat e hetimit tatimor, për zbulimin, parandalimin e luftën kundër krimit tatimor dhe veprat penale”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 23 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Në sektorin e ndërtimit,
- Sektori bankar duke përdorur agjentët imobiliar
- Rritja fiktive e vlerës reale të pasurive të paluajtshme
- Paraja elektronike- gjurmueshmëria

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit funksional të administratës tatimore lidhur me teknikat e hetimit tatimor.

Foto nga trajnimet me punonjësit e nivelit funksional të administratës tatimore



AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE

Trajnime të punonjësve niveli vazhdues

AKTIVITETI I

"Kontabiliteti i zgjeruar."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në Tiranë morën pjesë 22 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Instrumentat financiare; Inventarët.
- Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet. Afatgjata Jomateriale; Provizionet; Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara, Kontabilizimi i qirave.
- Të ardhurat dhe lidhja e tyre me shpenzimet, shpenzimi i tatimit mbi fitimin dhe tatimi i shtyrë.
- Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi, grantet dhe forma të tjera të ndihmës, efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit.
- Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare, trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta, kontabiliteti dhe raportimi financiar i mikronjesive ekonomike

Objektivi i këtij trajnimi i punonjësve të nivelit vazhdues të administratës tatimore lidhur me parimet e kontabilitetit dhe mënyrën e funksionimit në sistem mes drejtorive.

AKTIVITETI II

"Marrëveshjet ndërkombëtare për eleminimin e tatimit të dyfishtë."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 29 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshë mes RSH dhe shteteve të tjera
- Udhëzimi Nr. 11,datë 23.7 2024 Për Zbatimin e Marrëveshjeve për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal
- Metoda e kreditimit të tatimit të huaj sipas ligjit shqiptar dhe marrëveshjeve tatimore

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit vazhdues të administratës tatimore lidhur legjislacionin për marrëveshjet dypalëshe që synojnë eleminimin e tatimit të dyfishtë.

AKTIVITETI III

“Ligji për tatimin mbi të ardhurat.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 53 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Fusha e zbatimit dhe perkufizimet.
- Tatimi mbi të ardhurat personale.
- Tatimi mbi të ardhurat e korporatave.
- Tatimi i mbajtur në burim.
- Tatimi i trashigimisë, dhuratave dhe lojrave të fatit.
- Deklaratat.
- Ndryshimet nga ligji i mëparshëm.

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit vazhdues të administratës tatimore lidhur me të ardhurat personale, tatimin mbi fitimin dhe tatimin në burim.

AKTIVITETI IV

“Transaksionet e tatueshme dhe vendi i furnizimit të tyre.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 46 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Furnizimi i mallit dhe vendi
- Furnizimi i shërbimeve dhe vendi
- Transaksionet e ndërmjetësve
- Përfaqësuesi tatimor

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit vazhdues të administratës tatimore lidhur me disa çështje të TVSH.

AKTIVITETI V

“Mbikqyrja e OJF-ve në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 25 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Procedurat që ndiqen nga organet tatimore për kontrollin e veprimtarisë së OJF-ve
- Shkëmbimi i informacionit mes DPT dhe DPPPP
- Kontrolli në terren i OJF-ve-pasqyrat financiare dhe rastet e dyshimta
- Analizimi i indikatorëve të riskut të financimi të terrorizmit në kuadër të OJF-ve

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit vazhdues të administratës tatimore lidhur me natyrën e regjistrimit dhe kontrollit të OJF-ve.

AKTIVITETI VI

“Lindja e tatimit, kërkueshmëria, vlera e tatueshme.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 42 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Lindja e tatimit, kërkueshmëria, momenti i lëshimit të faturës
- Vlera e tatueshme e furnizimit
- Përcaktimi i vlerës
- Rimbursimi

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit vazhdues të administratës tatimore lidhur me cështje të ligjit të TVSH që lidhen me lindjen e tatimit, kërkueshmëria, vlera e tatueshme.

AKTIVITETI VII

“Shkalla tatimore, përjashtimet, e drejta e zbritjes.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të Administratës Tatimore. Në trajnimin e zhvilluar në rajonin qendror morën pjesë 33 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUAR.

- Furnizimet me shkallë zero, eksportet, importet
- Përjashtimi nga TVSH
- Kriteret formale dhe të veçanta të zbritjes

Objektivi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të nivelit vazhdues të administratës tatimore lidhur me cështje të ligjit të TVSH që lidhen me shkallën tatimore, përjashtimet, e drejta e zbritjes.

Foto nga trajnimet me punonjësit e nivelit vazhdues të administratës tatimore



AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të punonjësve niveli funksional

AKTIVITETI I

"IPR- Pronësia intelektuale."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet përgjegjës, specialist, jurist dhe doganier. 16

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Patentat dhe modelet e përdorimit;
- Disenjot industrial;
- Markat tregtare dhe të shërbimit;
- Treguesit gjeografikë;
- Qarqet e integruar.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me pronësinë intelektuale, markat dhe patentat, nisjen e procedurave. Ky trajnim u zhvillua për thellimin e njohurive për punonjësit e administratës doganore në këtë fushë.

AKTIVITETI II

"Hapat e Hartimit të Kërkesave Buxhetore."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet përgjegjës, specialist, jurist dhe doganier. 15

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Hapat e hartimit të kërkesave buxhetore;
- Planifikimi i projekteve të investimeve publike;
- Monitorimi i buxhetit;
- Shembuj praktik të dokumentacionit të hartimit të kërkesave buxhetore proçesit të menaxhimit të investimeve publike, raporteve të monitorimit.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore dhe kuadrin ligjor në fuqi. Ky trajnim u zhvillua për thellimin e njohurive për punonjësit e administratës doganore në këtë fushë.

AKTIVITETI III

"Siguria Kibernetike."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me 15 pjesëmarrës në pozicionet doganier regjimesh, akcize dhe mbikqyrës.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Çfarë është siguria kibernetike;
- Bazat e sigurisë kibernetike;
- Siguria e Sistemeve të Informacionit;
- Kërcënimet për sigurinë kibernetike;
- Pajisje celular, akses në distancë dhe mediat sociale;
- Legjislacioni në Shqipëri, strukturat përkatëse;
- Si të mbrohemi.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të sigurisë kibernetike, legjislacionin në fuqi, strukturat përkatëse.

AKTIVITETI IV

"Kontrolli pas zhdoganimit."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 14 pjesëmarrës në pozicionet doganier aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Llojet e kontrollit;
- Rëndësia e kontrollit;
- Analiza, kryerja dhe dokumentimi i kontrolleve, praktikë.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore mbi llojet e kontrollit pas zhdoganimit, diskutimi i rasteve praktike.

AKTIVITETI V

“Regjimet doganore.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet përgjegjës, specialist, jurist dhe doganier. 20

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- RLP me përjashim të plotë;
- Magazinat doganore dhe zonat e lira;
- Përpunimi aktiv;
- Përpunimi pasiv.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me regjimet doganore, përpunimin aktiv dhe pasiv, diskutimin e rasteve praktike të paraqitura pranë degëve doganore.

AKTIVITETI VI

“Lejimi i Përkohshëm.”

Kodi Doganor ka percaktuar:

TITULLI VII, REGJIME TË POSAÇME, KREU I, DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 191: Fusha e zbatimit

Mallrat mund të vendosen nën një nga kategoritë e mëposhtme të regjimeve të posaçme:

a) transit, i cili përfshin transitin e jashtëm dhe të brendshëm;

b) magazinim, i cili përfshin magazinimin doganor dhe zonat e lira;

c) përdorimin e veçantë, i cili përfshin lejimin e përkohshëm dhe përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use);

ç) përpunim, i cili përfshin përpunimin aktiv dhe pasiv.

Për këtë arsye kjo temë u shpjegua në temën e regjimeve doganore, duke mos qenë më nevoja për tu trajtuar si temë më vete.

AKTIVITETI VII

“Vlera doganore.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet përgjegjës, specialist, jurist dhe doganier. 11

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rendësia e vlerësimit doganor të mallrave;
- Metodat e vlerësimit;
- Transferimi i çmimit;
- Diskutim raste praktike.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me rëndesinë e vlerësimit doganor të mallrave, metodat e vlerësimit, transferimin e çmimit, diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI VIII

"Inteligjenca operative."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet specialist dhe doganier. 11

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Mbledhja dhe përdorimi i inteligjencës operative.
- Baza e të Dhënave nCEN (national customs network database)

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me bazën e të dhënave nCEN si instrument i rëndësishëm në kryerjen e detyrave të përditshme në fushën e zbatimit të ligjit dhe vecanërisht inteligjencës.

AKTIVITETI IX

"Laboratori doganor dhe mostrimi."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet doganier kontrolli fizik dhe mbikqyrje. 13

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Udhëzimin mbi "Procedurat e mostrimit, transportimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve të analizave laboratorike";
- Manuali i mostrimit;
- Marrja e mostrës;

- Veprimet për të adresuar rreziqet dhe mundësitë;

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me Udhëzimin Nr. 1, Nr.2477/1 Prot., datë.14.02.2023 "Procedurat e mostrimit, transportimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve laboratorike dhe Manualin e Mostrimit". Pasqyrimi i ndryshimeve të Udhëzimit në hapat e kalimit të praktikave në sistemin LIMS (Laboratory Information Management System) si dhe për Skedat e Mostrimit, procedurat e mostrimit, sipas natyrës së mallrave.

AKTIVITETI X

"Akciza, përjashtimet, diferencat, rimbursimi, inventarizimi."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet doganier akcize dhe mbikqyrje. 24

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Përjashtimet;
- Diferencat;
- Rimbursimi;
- Inventarizimi.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me rëndesinë e akcizës, përjashtimet nga akciza, diferencat, rimbursimi, inventarizimi, diskutimi rasteve praktike.

AKTIVITETI XI

"Origjina e mallrave."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori. 17

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Shpjegimi i ndryshimeve me raste konkrete ndërmjet rregullave të origjinës së Konventës PEM të 2012 (Ligji 1/2012) dhe Konventës së Rishikuar PEM të 2023 (Ligji 59/2024);
- Rishikimi i Dispozitave të MTL-ve përkatëse – përjashtimi i Turqisë nga rishikimi i protokollit B të rregullave të origjinës.
- Shpjegimi i provave të origjinës preferenciale dhe jo preferenciale: Certifikata e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Certifikata EUR.1, Form A, Deklara-Origjinës;

- Informimi dhe detajimi i kodeve të dokumentave bashkangjitur n= Asycuda sipas provave të origjinës në funksion të setit të rregullave të përdorur;
- Raste praktike mbi mënyrën e plotësimit të kutisë 7 të certifikatës EUR.1 dhe DO në varësi nga seti I rregullave të përdorura, vendi I eksportit dhe I destinacionit.
- Sqarimi i rolit të Deklaratave të Furnitorit në zinxhirin e origjinës së mallrave;
- Llojet e Deklaratave të Furnitorit;
- Raste praktike të përdorimit të DF sin jë document mbështetës për lëshimin e provave të origjinës;
- Përkufizimi dhe dallimet ndërmjet kumulimit bilateral, diagonal dhe të plotë;
- Paraqitje e situateës konkrete të MTL-ve në fuqi që lejojnë lloje të ndryshme të kumulimit;
- Raste praktike të ndryshimeve gjatë trajtimit doganor kur zbatohen lloje të ndryshme të kumulimit të origjinës;

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me rregullat e origjinës, diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI XII

“Kontrabanda: Padia, Zgjidhja Administrative, Kazuse.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori. 12

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Padia për Kontrabandën.
- Zgjidhja Administrative e Kontrabandës.
- Kazuse dhe Praktikat më të Mira

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me kontrabandën padinë, zgjidhjen administrative, kazuse. Diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI XIII

“Kapjet Doganore (kapjet Cash).”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori. 21

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rregullat dhe legjislacioni mbi kapjet doganore të parasë në dorë (cash)
- Çfarë kufizimesh dhe raportimesh kërkohen për para të gatshme që kalojnë kufirin?
- Ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare që rregullojnë kapjet.
- Procedurat e kontrollit dhe kapjes së parasë në kufi
- Si realizohet kontrolli i bagazhit dhe dokumenteve?
- Mjetet dhe teknikat e përdorura për të zbuluar para të paligjshme.
- Identifikimi i parasë së dyshimtë dhe parandalimi i pastrimit të parave
- Si dallohen paratë që mund të jenë të lidhura me aktivitete kriminale?
- Bashkëpunimi me autoritetet e tjera (p.sh. policinë financiare).
- Dokumentimi dhe raportimi i kapjeve doganore
- Çfarë dokumentacioni duhet të përpilohet pas kapjes?

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore kapjet doganore (kapjet cash). Diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI XIV

“Rregullat alternative të origjinës preferenciale. Rregullat tranzitore.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me 21 pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rregullat e origjiniës preferenciale në zbatim.
- Produkte origjinuese.
- Komulimi i plotë.
- Kthimi i detyrimeve doganore.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore në fushën e rregullave alternative të origjinës preferenciale. Diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI XV

“Metodologjia e kontrollit fizik dhe procedurat e sekuestrimit të mallrave.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me 21 pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Procedurat që ndërmerren në rastet e kontrollit fizik.
- Kur ndodh ky kontroll?
- Dokumentet plotësuese.
- Rastet kur sekuestrohen mallrat.
- Sanksionet.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore në lidhje me kontrollin fizik dhe proçedurat e sekuestrimit të mallrave. Diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI XVI

“Bashkëpunimi ndërkombëtar.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me 7 pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Aplikimet në programet komunitare.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore në menaxhimin e marrëdhenieve me admnistratat doganore homologe të vendeve të tjera, me partnerët e huaj brenda dhe jashtë vendit.Gjithashtu trajnimi trajton dhe Legjislacionin e BE-së në fushën e bashkimit doganor si dhe mbrojtjen efektive, sistemet relevente të kompjutizuara, si dhe diskutimin e rasteve praktike.

AKTIVITETI XVII

“Ligji i TVSH, fiskalizimi dhe marrëdhënia doganë-tatime.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me 6 pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

• Njohja me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

• Procesi i fiskalizimit.

• Komunikimi i ndërsjelltë doganë-tatime.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore. Roli i doganës në mbledhjen e TVSH-së në import. Momentet e lindjes së detyrimit të TVSH-së në doganë. Baza e tatueshme për TVSH-në në import (vlera doganore + taksa doganore + akcizë). Trajtimi i TVSH-së për: importet për qëllime tregtare, importet për përdorim vetjak, importet nga subjektet e përjashtuara nga TVSH.Përjashtimet dhe lehtësitë e TVSH-së në import sipas ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare

AKTIVITETI XVIII

"Sistemi backend."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të administratës doganore, me 5 pjesëmarrës në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

• Problematikat e sistemit Backend.

• Back-end në lidhe me autorizimet.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore. Trajtimi i njohurive të përgjithshme mbi platformën Backend, mënyra e përdorimit sipas strukturave në administratën doganore.

Foto trajnime niveli funksional

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të punonjësve niveli vazhdues

AKTIVITETI I

“Klasifikime tarifore dhe IDT”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me 34 pjesëmarrës në pesë degë doganore në pozicionet doganier dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Klasifikime tarifore dhe IDT.
- Operacionet e privilegjuara.
- Përjashtimet dhe detyrimet.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me tarifen doganore, detyrimet e importit dhe masat e tjera të parashikuara nga dispozitat që rregullojnë fusha të veçanta që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave.

AKTIVITETI II

“Asycuda World, Oracle”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me 38 pjesëmarrës në pesë degë doganore në pozicionet doganier dhe specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Prezantimi i sistemit ASYCUDA World: çfarë është, qëllimi dhe përfitimet.
- Komponentët kryesorë të platformës dhe si ndërveprojnë (modulet për deklarim, pagesa, menaxhim risku, etj.).
- Si integrohet me sistemet kombëtare doganore dhe të tjera institucionale

AKTIVITETI III

“Origjina e mallrave.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me 44 pjesëmarrës në pozicionet doganier mbikqyrje, kontrolli fizik, regjimesh dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Konventa PEM (qëllimi, vendet palë, arsyet për rregullat e reja), Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë që zbaton vendi ynë si dhe lidhja e protokolleve përkatëse të tyre të origjinës me Konventën PEM.
- Konventa e rishikuar nga Turqia në tregtinë me vendin tonë si dhe me të gjitha vendet e tjera pjesë në Konventën PEM.
- Zbatimi i saktë i dispozitave ligjore në tregtinë me Mbretërinë e Bashkuar.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore që të zbatojnë në mënyrë të saktë rregullat ekzistuese dhe rregullat e rishikuara të origjinës në bazë të Konventës PEM për lëshimin/pranimin e dokumenteve të origjinës preferenciale. Të njihen me rregullat e origjinës në një situatë komplekse kur në MTL me Turqinë nuk është bërë lidhja dinamike me Konventën, si dhe specifikat e marrëveshjes me Mbretërinë e Bashkuar.

Diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI IV

“DATABAZA E TË DHËNAVE.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me 38 në 5 degë doganore, pjesëmarrës në pozicionet doganier mbikqyrje, kontrolli fizik, regjimesh dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- SQL, Query, Pivot Table, Visual report, ETL, etj.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me databazën e të dhënave. Pjesëmarrësit të njohin rolin e databazave në menaxhimin e informacionit doganor, kontrollin e mallrave, monitorimin e operatorëve ekonomikë dhe parandalimin e shkeljeve.Diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI V

“RREZIQET E KORRUPSIONIT NË ADMINISTRATËN DOGANORE.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me 36 në 5 degë doganore, pjesëmarrës në pozicionet doganier mbikqyrje, kontrolli fizik, regjimesh dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Integriteti dhe masat anti-korrupsion qasja parandaluese.
- Integriteti dhe masat anti-korrupsion qasja ndëshkuese.
- Njohja e parimeve të nivelit të lartë kundër korrupsionit në Dogana G20.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me rreziqet e korrupsionit në administratën doganore. Pjesëmarrësit të njohin çfarë është korrupsioni, format e tij (shpërdorimi i detyrës, ndikimi i padrejtë) dhe mënyrën si manifestohet në administratën doganore. Diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI VI

“PLATFORMA CLICK. MODULET ONLINE WCO.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me 29 në 5 degë doganore, pjesëmarrës në pozicionet doganier mbikqyrje, kontrolli fizik, regjimesh dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Platforma
- Mundësitë
- Logimi
- Përdorimi

• Kryqëzimi i Praktikave më të mira

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me platformën CLICK. Përdorimi i rasteve praktike dhe shembuj konkretë që do të ndihmojnë pjesëmarrësit të kuptojnë më mirë se si aplikohen këto rregulla në praktikë.

AKTIVITETI VII

"NCTS."

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit vazhdues të administratës doganore, me 36 në 5 degë doganore, pjesëmarrës në pozicionet doganier mbikqyrje, kontrolli fizik, regjimesh dhe specialist aposteriori.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

• New Compiuterised Transit Sistem.

